

Numri i lëndës në Gjykatën Themelore  
Ppr 11/2013

23 qershor 2014

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**, në kolegjin e përbérë prej gjyqtarit të EULEX-it Dag Brathole si kryetar i kolegjit, dhe gjyqtares së EULEX-it Esma Erterzi dhe gjyqtares së Gjykates Supreme Nesrin Lushta si anëtarë të kolegjit, të ndihmuar nga zyrtarja ligjore e EULEX-it Natalie Dawson në cilësi të procesmbajtëses,

Në lëndën penale kundër:

X/ ✓.

I dyshuar për veprat penale:

*Vrasje e rëndë* në formë të *privimit nga jeta personin tjetër përmotiv kombëtarë* në bashkëkryerje, sipas nenit 179 (1.10) në lidhej me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës, dhe të penalizuar me tutje në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30(2) të LPKSAK-së lidhur me nenin 22 të KPRSFJ-së;

*Vrasje e rëndë* në *tentativë* në formë të *privimit nga jeta personin tjetër përmotiv kombëtarë* në bashkëkryerje, duke rezultuar me lëndim të rëndë trupor në bashkëkryerje, sipas neneve 179(1.10) dhe 189(2) lidhur me nenet 28, 31 dhe 189(2.1) dhe (5) të KPK-së të penalizuar më tutje në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30(2) dhe nenit 38(2) të LPKSAK-së lidhur me nenin 19 dhe 22 të KPRSFJ-së;

*Vrasje e rëndë* në *tentativë* në formë të *privimit nga jeta personin tjetër përmotiv kombëtarë* në bashkëkryerje, sipas nenit 179(1.10) lidhur me nenet 28 dhe 31 të Kodit Penal të Kosovës, të penalizuar më tutje në kohën e kryerjes së veprës penale sipas nenit 30(2) të LPKSAK-së lidhur me nenin 19 dhe 22 të KPRSFJ-së;

Duke vendosur lidhur me kërkësën përmbrrojtje të ligjshmërisë së paraqitur më 5 maj 2014nga avokati mbrojtës në emër të , X/ ✓.

Duke marrë parasysh mendimin e Zyrës së Prokurorit të Shtetit të Republikës së Kosovës (ZPSH) të paraqitur më 12 qershor 2014;

Pas këshillimit dhe votimit, në përputhje me nenin 435 të KPP-së, Gjykata Supreme lëshon këte:

XKTGJYKIM

1. Kërkesa pér mbrojtje të ligjshmërisë e paraqitur nga **A. V. PRANOHET.**
2. Aktvendimet e Gjykatës së Apelit të datës 20 prill 2014 dhe 26 prill 2014 ANULOHEN dhe lënda KTUEHET në Gjykatën e Apelit pér vendim tjetër.

#### ARSYETIMI

##### 1. Historia e procedurës

- a. Hetimi penal ka filluar më 21 shkurt 2013 me aktvendim pér fillimin e hetimit. Hetimi është zgjeruar më 10 mars 2014 pér të përfshirë edhe të pandehurin Vujacic.
- b. Më 15 prill 2014 i pandehuri është arrestuar dhe është sjellë para gjyqtarit të procedurës paraprake pér shqyrtim mbi paraburgjm.
- c. Gjyqtari i procedurës paraprake caktoi masën e paraburgimit pér një (1) muaj, që skadon më 15 maj 2014. Më 17 prill i pandehuri vetë paraqiti ankesë kundër këtij aktvendimi.
- d. Më 20 prill 2014 Gjykata e Apelit e refuzoi këtë ankesë dhe e vërtetoi aktvendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake.
- e. Më 18 prill 2014, avokati mbrojtës paraqiti ankesë përmes postës në emër të të pandehurit, të cilën Gjykata Themelore në Mitrovicë e pranoi më 22 prill 2014.
- f. Më 26 prill 2014, Gjykata e Apelit lëshoi një aktvendim me të cilin e hedh poshtë ankesën e avokatit mbrojtës si të papranueshme.
- g. Më 5 maj 2014, avokati mbrojtës paraqiti kérkesë pér mbrojtje të ligjshmërisë kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake të Gjykatës Themelore e të Mitrovicës, të datës 15 prill 2014, dhe kundër aktvendimeve të lartpërmendura të Gjykatës së Apelit të Prishtinës, të datës 20 prill 2014 dhe 26 prill 2014.
- h. Më 9 qershor 2014, Kërkesa pér mbrojtje të ligjshmërisë është dorëzuar te Prokurori i Shtetit, i cili paraqiti përgjigjen e tij më 12 qershor 2014.

##### 2. Parashtresat e palëve

###### Mbrojtja

- a. Dyshimi i bazuar nuk është vërtetuar në aktvendimin e Gjykatës Themelore, e as nga Gjykata e Apelit.
- b. Gjykata e Apelit gabimisht e ka refuzuar më 26 prill 2014 ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës më 22 prill 2014. Fakti se Gjykata e Apelit ka vendosur paraprakisht lidhur me ankesën e paraqitur nga i pandehuri nuk do të thotë se nuk duhet ta shqyrtojë ankesën e paraqitur më vonë nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit. Gjykata e Apelit ishte e obliguar të vendosë pér të dy ankesat me aktvendim të njëjtë, pér dallim nga dy aktvendimet e ndara, lidhur me ankesat e paraqitura nga i pandehuri dhe nga avokati mbrojtës.

###### Prokurori i apelit

- i. Gjykata Themelore ka dhënë arsyetim të mjaftueshém pér vendimin mbi caktimin e paraburgimit ndaj këtij të pandehuri.
- ii. Gjykata e Apelit i ka adresuar të gjitha argumentet e ngritura nga i pandehuri në ankesën e tij.
- iii. Sipas nenit 61(1) të KPP-së avokati mbrojtës në këtë kuptim i gjëzon të njëjtat të drejta sikurse i pandehuri, dhe sipas nenit 189(3) të KPP-së secila palë mund të paraqesë ankesë brenda 24 orëve nga koha e dorëzimit të aktvendimit të kundërshtuar.
- iv. Prandaj avokati mbrojtës nuk ka pasur të drejtë të paraqesë ankesë veçmas nga i pandehuri, dhe Gjykata e Apelit kishte vendosur më parë lidhur me ankesën e paraqitur nga i pandehuri.
- v. Prandaj Gjykata e Apelit nuk ka shkelur dispozitat e procedurës penale.
- vi. Aktvendimet e kundërshtuara duhet të vërtetohen dhe kërkesa pér mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet.

## **2. Gjetjet e gjykatës:**

- a. Kërkesa pér mbrojtje të ligjshmërisë është e pranueshme dhe e paraqitur me kohë.
- b. Kolegji i ka shqyrtauar me kujdes veprimet e ndërmarra nga Gjykata e Apelit në këtë lëndë.
- c. Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë i datës 15 prill 2014 i është dorëzuar të pandehurit më 17 prill 2014. Nuk ka prova pér datën e dorëzimit të aktvendimit te avokati mbrojtës. Sipas nenit 189(2) të KPP-së duhet t'i dorëzohet të pandehurit si dhe avokatit mbrojtës veçmas.
- d. I pandehuri vendosi ta përpilojë dhe ta paraqesë vetë ankesën. Gjykata Themelore e ka pranuar këtë ankesë 17 prill 2014. Gjykata e Apelit e ka pranuar këtë ankesë më 19 prill 2014.
- e. Sipas procedurës nga nen 189(3) i KPP-së, më 20 prill 2014 Gjykata e Apelit mbajti këshillim lidhur me këtë ankesë.
- f. Avokati mbrojtës paraqiti edhe një ankesë tjetër në emër të të pandehurit. Kjo ankesë u dorëzua në Gjykatën Themelorë të Mitrovicës më 18 prill 2014. Gjykata Themelore e Mitrovicës e pranoi këtë ankesë më 22 prill 2014, dhe Gjykata e Apelit më 25 prill 2014. Sipas nenit 445(3) të KPP-së data e postimit konsiderohet si datë e dorëzimit të ankesës, dhe prandaj anesa e avokatit mbrojtës konsiderohet se është dorëzuar në Gjykatën Themelore të Mitrovicës më 18 prill 2014.
- g. Kolegji vërteton se sipas nenit 61(1) të KPP-së i pandehuri dhe avokati mbrojtës konsiderohen se e përbëjnë një palë të vetme në procedurë penale, dhe se nen 19(1)(1.15) i KPP-së përkufizon prokurorin e shtetit, të pandehurin dhe të diemtarin si palë në procedurë.
- h. Në këshillimin e mbajtur më 22 prill 2014 lidhur me ankesën e të pandehurit, Gjykata e Apelit i është permblatur procedurës së përcaktuar sipas KPP-së. Kolegji vërteton se Gjykata e Apelit kur e ka mbajtur keshillimi nuk ka mundur të jetë në dijeni pér ekzistimin e ankesës, ose pér qëllimin e avokatit mbrojtës pér ta

paraqitur ankesen, ende pa e pranuar Gjykata Themelore e Mitrovicës ankesën e avokatit mbrojtës. Gjykata e Apelit ishte e obliguar t'i përmbahet procedurës së perkufizuar në nenin 189(3) të KPP-së, gjë që edhe e ka bërë.

- i. Pavaresisht kësaj, neni 398(3) i KPP-së është i qartë se Gjykata e Apelit duhet të vendos të gjitha ankesat e të njëjtë aktgjykim me një vendim të vetëm. Prandaj, kolegji arrin në përfundim se, pasi të gjitha janë të barabarta, Gjykata e Apelit është dashur të mbajë këshillim pér ankesën e paraqitur nga vetë i pandehuri dhe pér ankesën e paraqitur nga avokati mbrojtës në emër të të pandehurit, në keshillimin e njëjtë, dhe të lëshojë një aktvendim pér të dy ankesat.
- j. Prandaj, kolegji vëren se vargu i ngjarjeve dhe kushtet procedurale të KPK-së kanë vendosur Gjykatën e Apelit në një situatë në të cilën pashmangshëm do ta shkelte rregullin e procedurës në procedurë penale pa marrë parasysh se çfarë veprimi ndërmerr. Shkelja e ligjit të procedurës penale prandaj ka ndodhur në secilin rast.
- k. Duke vendosur se çfarë veprimi të merret, kolegji arrin në përfundim se, duhet të mbizotërojnë të drejtat themelore të të pandehurit, duke përfshirë edhe të drejtën pér avokat mbrojtës. E drejta e të pandehurit pér t'u dëgjuar është fondamentale. Prandaj, si baraspeshim kolegji gjen se aktvendimet e datës 20 prill 2014 dhe 26 prill 2014 duhet të anulohen dhe se lënda duhet të kthehet në Gjykatën e Apelit me qëllim që të mbahet vetëm një këshillim pér t'i shqyrtaur të dyja ankesat bashkë.
- l. Në ndërkohë, duhet të mbizotëroje parimi *status quo*. I pandehuri duhet të mbahet në paraburgim deri në vendimin tjetër të Gjykatës së Apelit.

Kryetar i kolegjit:

---

Dag Brathole  
Gjyqtar i EULEX-it

Procesmbajtëse:

---

Natalie Dawson  
Zyrtare ligjore e EULEX-it

Anëtarë të kolegjit:

---

Esma Erterzi  
Gjyqtare e EULEX-it

---

Nesrin Lushta  
Gjyqtare e Gjykatës Supreme